Kjo kompani përdor cookies të popullarizuara. Këto janë dokumente të padukshme që ruhen përkohësisht në një vend në hard disk të konsumatorit dhe web-faqja atyre ju lejon

të njohin një kompjuter të konsumatorit kur ata vizitojnë faqen e tyre herën tjetër. Cookies përdoren vetëm për të mbledhur informacion në lidhje me përdorimin e faqes së internetit.²⁹

Në TopShop i kushton vëmendje të veçantë sigurisë së të dhënave personale. Ata theksojnë se informacioni personal është i mbrojtur nga humbja, shkatërrimi, falsifikimi, manipulimi dhe akses i paautorizuar ose zbulimi i paautorizuar i konsumatorëve.

Konsumatorët zakonisht japin vëmendje për kompanitë që atyre u ofrojnë përfitime të ndryshme, kartat e anëtarësimit, dhurata etj. Pikërisht Top Shop si pjesë e këtij punimi për marketingun e drejtpërdrejtë, e ka një sistem të tërë të lehtësirave që ofrohen si pjesë e cilësisë së përgjithshme të produktit nga ana e tyre, që e merr konsumatori. Klubi i tyre ekskluziv në të cilin mund të anëtarësohen klientët e tyre quhet Club 5 * (Five Star Club). Të gjithë anëtarët e Klubit 5 * gëzojnë përfitimet e çmimeve më të lira, dhurata të veçanta dhe oferta të ndryshme të kufizuara. Anëtarët e Klubit 5 * kanë të drejtë për marrëveshje të shkëlqyera me TopShop dhe ofrimin e përparësive të produkteve të porositura.³⁰




Foto.1. Web faqja e TopShop Kosova

Marketingu i drejtpërdrejtë me buletin dhe me email

TopShop përdorë "Newsletters" (buletinet) për të tërhequr vëmendjen e konsumatorëve. Fjala Newsletter erdhi duke bashkuar fjalën "Newspaper" (gazeta) dhe "Informational letter" (letra informuese). Buletinet shpërndahen në mënyrë të drejtë në kohë reale dhe strajtojnë një temë që është me interes të veçantë për ata të cilët raportuan se do të donin t'i pranonin informacionet në emailin e tyre. Kohët e fundit, ky lloj i marketingut të drejtpërdrejtë është shumë popullor dhe i afrohet klientëve nëpërmjet një

²⁹ Edmond Beqiri, Interneti -komunikimet kompjuterike, IOM, Prishtinë, 2002, fq. 36

³⁰ <http://www.topshop-ks.com> (10.6.2018)

mënyre të personalizuar. Përdoret për shkak të tendencës së përgjithshme të kalimit nga mediat e shtypura në ato dixhitale.

Informacioni, në përputhje me vetë subjektin, mund të dërgohet tek anëtarët, klientët ose punonjësit. Përdorimi i buletineve në marketing është bërë një praktikë e zakonshme si një mënyrë për të komunikuar me klientët e tanishëm dhe të ardhshëm.

Nëse Newsletter ka vetëm karakter të reklamave, ose ofron përmbajtje të parëndësishme, rezultati më i zakonshëm është lodhja e pranuesit-konsumatorit nga newsletter dhe çregjistrimi nga në lista e marrësve të buletinit.

Ndryshe nga buletinet, marketingu i drejtpërdrejtë me e-mail, përfshin dërgimin e-mail me të vetmin qëllim të promovimit të produkteve dhe shërbimeve dhe kompanitë nuk duhet të dërgojnë ato në intervale të rregullta, por vetëm kur ekziston nevoja për promovim.

Përdorimi i rrjeteve sociale nga OriFloame-Avon

Në vitet e fundit përdorimi i rrjeteve sociale është rritur në masë të madhe. Përdorimi i gjërë i këtyre rrjeteve i kanë nxitur sipërmarrjet e reja të promovojnë ofertat e tyre të ndryshme përmes profilin e tyre, duke e mbajtur të informuar klientin në çdo kohë dhe duke tentuar tërheqjen e klientëve potencialë. Këto sipërmarrje në rrjete sociale informojnë në vazhdimësi rreth ofertës së tyre, por jo gjithmonë janë të kompletuara informatat të cilat i nevojiten klientit, siç është p.sh. çmimi. Prandaj ekziston mundësia për marrjen e informatave shtesë përmes butonit për mesazhe. Personat të cilët e menaxhojnë profilin online të kompanisë, i përgjigjen në kohë reale mesazheve të klientëve.

Përmes rrjeteve sociale siç janë: Facebook, Instagram, etj. ofrohet mundësia për të kontaktuar direkt me ofruesin e produktit apo shërbimit, qoftë përmes butonit të mesazhit, apo numrit të telefonit të vendosur në profilin e tyre.

Rrjetet sociale janë në përdorim nga shumë biznese sipërmarrëse të reja dhe pritet që në të ardhmen të kenë prezencë në to, pothuaj se të gjitha bizneset e regionit.

Pyetjet kërkimore

Në suksesin e platformave online deri më tani është konsideruar të jetë cilësia e shërbimit, kënaqësia e konsumatorëve. Nga kjo kuptojmë se kompanitë vendore janë të ballafaquara me konkurrencë nga kompani gjigante qoftë edhe për tregun vendor. Gjatë rishikimit të literaturës është vërtetuar se krijimi i një baze besnike të konsumatorëve është i domosdoshëm për të arritur sukses në një periudhë afatmesme apo afatgjatë, qoftë për kompani lokale apo ndërkombëtare. Ndërlidhja në mes të cilësisë së shërbimeve, besnikërisë ndaj firmes që ka konsumatori dhe qasja e klienteve në shërbimet online që dita ditës shënon ngritje në rrjete sociale dhe ka bërë buje të madhe krijon bazën strukturore të këtij punimi.

Pyetjet kërkimore të cilat ky studim i adreson janë:

1. Çfarë ndikimi kanë komponentet e cilësisë së shërbimit në krijim të besnikërisë ndaj Firmes?
2. Si të bëjmë porosi online?
3. Sa janë të kënaqur konsumatorët me shërbimin online?

4. A bëni porosi me poste dhe sa është e sigurt dërgesa tek adresa e klient?
5. Çfarë dimesioni ka pakoja, në peshë dhe sa kushton pagesa Brenda Kosovës?
6. Sa kushton dërgesa jasht Kosovës?
7. Cilat janë mundësitë e pagesës?

Në vendin tonë ka shumë webfaqe që veprojnë online po në këtë fushë ka munges të dukshme të literaturë për sa i përket sjellje së konsumatorëve dhe implikimeve në krijimin e markave të sukseshme në tregun kosovar. Një përgjigjet e mundshme për këto pyetje është e dobishme për të kontribuar në diskutimin akademik të sotëm dhe për të ndihmuar kompanitë që veprojnë në këtë fushë, duke marrë parasysh se kjo marrëdhënie ndikon drejtpërsëdrejti në përfitimin e tyre afatgjatë.

Përgjigjet nga kompania TOP SHOP

Gjatë hulumtimit ne ju kemi adresuar kompanisë topshop-Kosova ku janë përgjigjur punëtorët e kësaj kompanie e cila vepron në Pejë. Përgjigjet kanë qenë të drejtpërdrejta, në lidhje me reklamimin e produkteve si dhe mundësia që ka një produkt apo shërbim për të kënaqur pritjet e konsumatorëve.

Përgjigjet konkrete që janë marrë janë:

1. Shërbimi i produktit është kualitativ, çmim i arsyeshëm;
2. Konsumatorët mund të kenë qasje në Web faqe dhe porositë mund ti bëjnë online apo dhe përmes numrit të telefonit 038 244 644 602
3. Të shumta janë produktet e kualitetit të lartë që kompani i ofron online në treg por këtu veçohet brendi i njohur Delimano që janë produktet të cilat konsumatorët kanë porositur online. Sot këto produkte gjenden në shumë shtepi të Kosovës duke mbajtur më vete vlerën e cilësisë, sigurisë dhe teknologjisë moderne.
4. Po bëhet porosi postë, dërgesa është 100% pagesa bëhet pas pranimit të porosisë. Kemi dy menyrë të pageses më post, kur ka ofertë të zbritjes të caktuar dhe dërgesa është falas ndërsa kur nuk ka ofertë dërgesa më poste kushton 4 euro duke përfshirë të gjithë territorin e Kosovës.
5. Pako ka dimesione të ndryshme varet nga produkti që konsumatorët e porosisin zakonisht, janë 5 me 5.

6. Nuk bëhen dergesa jasht Kosovës.

7. Mundesitë e pageses janë: konsumatorët mund të paguajnë në dyqan kesh, me karte si dhe përmes bankes.³¹

Përgjigjet e pyetësorit nga Top Shop Pejë, janë paraqitur grafikisht në grafikun e mëposhtëm:




Fig 2. Përgjigjet në pyetjet nismëtare për kompaninë online Top Shop në Kosovë

Përgjigjet nga Oriflame_Avon Peje

Kjo veb faqe është hapur që 3 vite në rrjetin social facebook dhe secili prej konsumatorëve mund të këtë qasje dhe mund të bëjë porosi online përmes grupit në facebook.

Sipas informacioneve të mbledhura nga kjo veb faqe produktet mund të porositën online nga vebfaqja si dhe të kryejmë porosi nga facebooku, si dhe përmes emailit ritta.m@live.com. Për produktet mund të njoftohemi përmes katalogut. Deri më tani nuk kanë të siguar transport. Produktet kryesisht janë kozmetike një pjesë e vogël ka byzhyteri. Porosit mund të meren nga konsumatorët në adresë të personit që drejton vebfaqen si dhe shpërndahen nga po i njëjti person. Furnizuesit janë nga përfaqësuesi Avon në Tiranë, ky përfaqësues furnizohet nga Polonia.

³¹ <http://www.topshop-ks.com> (10.6.2018.)

Për realizimin e këtij pyetësi ne iu qasëm një studimi dhe duke bërë hulumtim në Webfaqe online. Një vebfaqe e cila ofron shërbime për klientet online të cilet mund të keni qasje përmes rrjetit social në facebook si dhe mund te bejnë porosi eshte Oriflame_Avon Peje (Rita. M).³²



33

Foto.3

Përgjigjet e pyetësorit nga veb faqja Oriflame avon Peje, janë paraqitur grafiksht në grafikun e mëposhtëm:




Figura 4. Përgjigjet nga kompania Oriflame

³² www.Oriflame.com (11.06.2018), Avon&Oriflame (Rita M.)-Peje

³³ www.Oriflame.com (11.06.2018)

Përfundim

Marketingu i drejtpërdrejtë është një nga instrumentet e promovimit, i cili kërkon të arrihet duke përdorur kanalet tradicionale promovuese, të tilla si TV, radio, interneti, buletinet, gazetatat, posta ... Mesazhi promovues është i drejtuar direkt për individin, duke përdorur një varietet të teknikave.

Në terma operative përbëhet nga organizimi, planifikimin, çmimet, duke përcaktuar strategjinë, përcaktimin e asortimentit, duke krijuar promovime dhe shumë detaje të tjera. Objektivat e marketingut të drejtpërdrejtë mund të janë shitja, jepja e ideve dhe udhëzimeve për konsumatorët në lidhje me konsumin, si dhe ruajtja dhe kultivimi i marrëdhënieve me konsumatorët. Qëllimi përfundimtar është të ndërtohet një marrëdhënie afatgjatë me konsumatorin. Ka dy karakteristika kryesore që e dallojnë atë nga llojet e tjera të marketingut. E para është që masazhi dërgohet direkt tek konsumatorët. Veçoria tjetër është se marketingu i drejtpërdrejtë krijon një thirrje për aksion apo veprim.

Marketingu i drejtpërdrejtë më shpesh përdoret nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me buxhet të limituar. Ai paraqet një formë të drejtpërdrejtë të aktiviteteve promovuese të cilat me anë të komunikimit interaktiv krijojnë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe të personalizuar tregtari - klienti. Qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë rrjedhin nga politika dhe objektivat e biznesit të kompanisë si dhe në mënyrë indirekte, nga objektivat e promovimit e produkteve dhe shërbimeve në tërësi.³⁴

Koncepti i marketingut të drejtpërdrejtë konsiston në identifikimin e konsumatorëve potencialë dhe kontaktimin e tyre me anë të një mesazhi të personalizuar. Ky mesazh duhet të tregojë avantazhet e të bërit biznes me kompaninë që inicoi veprimin dhe mënyrën se konsumatorët duhet të përgjigjet.

Internet marketingu është një term i përgjithshëm për blerësit dhe shitësit të cilët përdorin mjete elektronike për hulumtime, komunikim dhe transaksionet e mundshme me njëri-tjetrin.³⁵ Tregu elektronik është i sponsorizuar nga faqet e internetit që përshkruajnë produktet dhe shërbimet e ofruara nga shitësit dhe u mundësojnë klientëve të shqyrtojnë, të mbledhin informacion, të identifikojnë se çfarë ata kanë nevojë dhe japin porositë e tyre duke përdorur një kartë krediti. Prandaj është veçanërisht e rëndësishme për bizneset që të përdorin një bazë të dhënash që përmban informacion të konsumatorëve potencialë.

Ka kanale të shumta për të fituar konsumatorët nëpërmjet marketingut të drejtpërdrejtë, të tilla si shitja direkte, email direkt, Katalog-marketingu, kiosk-marketingu, Telemarketingu, televizioni dhe mediat e tjera të marketingut të drejtpërdrejtë, si dhe marketingu online.

Kompania "Top Shop" është sot një nga kompanitë kryesore të njohura për marketing të drejtpërdrejtë të saj dhe produkteve të cilësisë që mund të gjenden nëpërmjet

³⁴ Xhorxh E. Belç, Majkël A. Belç, Reklamimi dhe Promovimi, NY, 2007, fq 137

³⁵ Deitel, Deitel and Nieto, "e-business & e-commerce", Prentice Hall, 2000, fq 37

reklama televizive. Mesazhi i fortë propagandues bëri që ata fituan një treg dhe sot janë ngritur në një nga shembujt e ndërmarrjes me histori të shkëlqyer të marketingut të drejtpërdrejtë.

Ndikimi i markave të tyre nuk është i kufizuar vetëm në vendet evropiane, por edhe më gjerë. Vizioni i tyre është që të bëhen shitës të nivelit botëror.

Konsumatorët e njohin këtë markë në turmën e kompanive të ngjashme, pikërisht për shkak të cilësisë së tyre të produktit, propagandës së fortë që vjen deri tek konsumatori dhe personalizimit të tyre. Reklamën e tyre televizive janë të dizajnuara në mënyrë të menduar. Ato përmbajnë të gjitha informatat në lidhje me produktin e kërkuar, mundësitë e pagesës, shpërndarjen dhe nganjëherë përmbajnë mesazhe në të cilat ata tregojnë përvojat e klientëve të kënaqur. Kështu, duke vepruar direkt në blerësit potencialë ata duan që të lënë një mesazh deri te konsumatori.

Kompanitë të cilat veprojnë me shitblerjen online janë kryesisht kompani private, nga të cilat konsumatorët mund të porosisin direkt mallra. Shitblerjet online janë bërë një nga qasjet e zakonshme për të kryer tregtinë në internet për biznesin dhe konsumatorin.

Kompanitë që ofrojnë produkte online kanë ardhur me ide krijuese për të promovuar produktin e tyre drejtpërdrejtë nëpërmjet internetit. Përdorimi i gjerë i internetit dhe rritja e teknologjisë kanë krijuar një treg të ri për klientët, ashtu edhe për bizneset. Interneti është një medium tjetër për të hyrë në kontakt me njerëzit që janë të interesuar për blerje.

Shitblerjet online janë poashtu një kanal i rëndësishëm për të gjetur klientët potencialë, si dhe për të vazhduar marrëdhëniet me klientët që janë të rregulltë. Ideja e blerjeve në internet mund të çojë konsumatorin në një mënyrë të përshtatshme për të ndjekur ofertën e shitjes në internet.

Konsumatorët poashtu janë në gjendje të kursejnë kohën që të zgjedhin produktin, dhe të tërheqin të gjithë informacione me pak klikime në pak minuta. Blerja mund të bëhet kudo, në çdo kohë sipas preferencave të tyre.

Sipas hulumtimit në regjionin e Pejës kompanitë që merren me shitblerje online janë në zhvillim e sipër. Bazur në rezultatet e studimit arrijmë në përfundim se për zhvillimin e tyre komponentet më të rëndësishme është reklama dhe konsumatori.

Mund të themi se çelësi i suksesit për të tërhequr vëmendjen e çdo konsumatori, për çdo kompani është reklamimi i mirë i produkteve.

Nga pyetësorëve në këtë studim, mund të konstatohet që vendi ynë ka nevojë për themelimin e ndërmarrësve të reja online, në mënyrë që ky segment i biznesit të ketë ngritje dhe zhvillim të mëtejshëm, me të cilin rast ky studim, mund të shërbejë si shembull për ndërmarrësit e ardhshëm.

Literatura

- Dallmer, H., Thedens, R., (1981.) Handbuch des Direct Marketing, Gabler Praxis: Wiesbaden

-
- Bernstein Gary (2015): *The principles of marketing*, Sagamore Publishing LLC, 1807 N. Federal Dr., Urbana, IL 61801
 - Beqiri Edmond, Interneti -komunikimet kompjuterike, IOM, Prishtinë, 2002;
 - Nexhbi Veseli&Teuta Veseli. **Marketing Management**. Alma, Shkup, Maqedoni, 8 / 2009. ISBN 978-9989-57-615-7
 - Nexhbi Veseli. **Principles of Marketing, 2nd Edition**. ALMA, Shkup, Maqedoni, 6 / 2009. ISBN 978-608-65058-0-6.
 - Philip Kotler & Gary Armstrong, Parimet e Marketingut, Tiranë, 2013;
 - Previšić, J., Ozretić Došen, Đ., (2014.) Marketing, 2. Dopunjeno i izmjenjeno izdanje, Adverta, Zagreb
 - Xhorxh E. Belç, Majkël A. Belç, Reklamimi dhe Promovimi, NY, 2007;
 - Abu Bashar and Mohammad Wasiq, E-satisfaction and E-loyalty of ConsumersShopping Online, Al-Falah School of Engineering & Technology, Faridabad (Haryana)
 - Deitel, Deitel and Nieto, "e-business & e-commerce", Prentice Hall, 2000.
 - Dickrell P., " Marketing ne internet per rritje te biznesit tuaj " Prentice –Hall. 2006
 - Zeithaml. Electronic Services Quality, Prentice Hall, New York, 2002

Burime të tjera

- <http://www.topshop-ks.com/>
- <https://forum.itshqip.com/threads/faqe-per-blerje-online.33537/>
- <http://smardonline.com/>
- [www.oriflame .com](http://www.oriflame.com)

SHBA DHE ZHBËRJA E JUGOSLLAVISË 1989-1995

Reshat Nurboja, Phd Candidate, Pejë, Kosovo
UET, Fakulteti: Shkenca Sociale
reshatnurboja@hotmail.com

Abstract

The focus of this paper reflects on the US foreign policy approach at the beginning of the American unilateralism era and its hesitation in the process of disintegration, namely the resolution of the crisis of the former Yugoslavia which threatened to take larger dimensions than the Balkans and at the same time because of unprecedented crimes since World War II, the credibility of not only the United States, NATO, the United Nations and the EU, but also the universal values of civilization and world civilization. The paper in itself reflects the complexity of defining the US foreign policy and combining numerous contradictory global and regional interests that have affected it. Initially in the hesitation of the US involvement in solving this Balkan crisis and then its engagement as a deciding factor in rounding off the first phase of solving this crisis with the arrival of the Dayton Agreement.

Key words: US, former Yugoslavia, War, Srebrenica massacre, Dayton Agreement.

Abstrakt

Në fokus të këtij punimi pasqyrohet çasja e politikës së jashtme të SHBA-së në fillim të epokës së unilitarizimit amerikan dhe hezitimi i saj të kyçët në procesin e dezintegritetit gjegjësisht zgjidhjen e krizës së ish Jugosllavisë e cila rrezikonte të mirrte përmasa më të gjëra se ballkanike dhe njëkohësisht për shkak të krimeve të papara që nga koha e Luftës së Dytë Botërore zbehte kredibilitetin jo vetëm të SHBA-së, të NATO-së, Kombeve të Bashkuara dhe të BE-së, por edhe vlerat univerzale të civilizimit dhe qytetritit botëror. Punimi, në vete pasqyron tërë kompleksitetin e përcaktimit të politikës së jashtme të SHBA-ve dhe gërshetimit të interesave të shumta kontradiktore globale dhe regjionale të cilat kanë ndikuar. Fillimisht në hezitimin e kyçjes së SHBA-së në zgjidhjen e kësaj krize ballkanike e më pastaj edhe angazhimit të saj si faktor determinues në rrumbullaksimin e fazës së parë të zgjidhjes së kësaj krize me arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit.

Fjalët kyçe: SHBA-të, ish Jugosllavia, Luftat, Masakra e Srebrenices, Marrëveshja e Dejtonit

Hyrje

Shpërbërja e Jugosllavisë ka koincedu me rënien e Murit të Berlinit, shpërbërjen së Bashkimit Sovjetik, paraqitjen e uniliteralizmit amerikan dhe ndryshimeve të tjera fundamenatale në diplomacinë ndërkombëtare. Për këtë arsye rëndësia strategjike dhe politike të ish Jugosllavisë për perendimin në veçanti për SHBA-të nuk ka paraqitur interes të veçantë sikurse dikur gjatë viteve të para së pas Luftës së Dytë Botërore. Meqenëse, Lufta e Ftohtë³⁶ në vitet që shtjellon punimi ka filluar të zbehet e me te edhe kërcnimi i presupozuar nga Rusia, ka ndikuar që rëndësia e Jugosllavisë si vend me interes strategjik nacional të SHBA-së të humb.

Fillimisht, për SHBA-të në atë periudhë kohore, si çështje shqetësuese në Jugosllavi pasqyrohej mund të themi vetëm shkelja dhe mohimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të shqiptarëve në Kosovë.

Për administartën amerikane kriza jugosllave konceptohej dhe është konsideruar si krizë lokale për të cilën duhet të angazhohet Evropa, gjegjësisht, ka mbizotëruar vlerësimi shtetror i Amerikës se shpërbërja e Jugosllavisë nuk paraqet ndonjë kercnim serioz për interesa nacionale të SHBA-së, nuk rrezikon stabilitetin dhe sigurinë e Evropës dhe të Ballkanit e as nuk mud të rrezikon kredibilitetin e organizatave ndërkombëtare në veçanti atë të NATO-së dhe Kombeve të Bashkuara.

Raportet SHBA –Jugosllavi gjatë kohës Luftës së Ftohtë

Politika e Jashtme e SHBA-së ndaj Jugosllavisë që nga pas Lufta e Dytë Botërore e sidomos pas refuzimit të Jugosllavisë të i bashkangjitet Paktit të Varshavës³⁷ gezonte në kontinuitet përkrahjen dhe ndihmen e SHBA-ve, meqenëse, Jugosllavia paraqiste një kundërpeshë ndaj bllokut sovjetik dhe për këtë arsye ajo gezonte një lloj pozicioni të privilegjuar nga Perëndimi.

Presidentët e asaj kohe të SHBA-ve: Hari S.Truman³⁸ dhe Dvajt Ajzenhauer³⁹ përkrahjen e tyre ndaj presidentit Jugosllav Josip Broz Tito e konsiderojshin si

³⁶ Lufta e Ftohtë ishte gjendja e tensioneve politike dhe ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore në mes SHBA-së, NATO-së nga një anë dhe Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të saja satelite që ishin në kuadër të Pajtit të Varshaves.

³⁷ Pakti i Varshavës ishte një Lidhje e shteteve komuniste të Evropës, e udhëhequr nga Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, i nënshkruar më 14 maj 1955 në Varshavë, me qëllim të miqësisë, bashkëpunimit dhe ndihmes reciproke në mes të Shqipërisë, Bullgarisë, Republikës Demokratike të Gjermanisë Polonisë, Rumanisë, Bashkimi të Republikave Socialiste Sovjetike, Republikës Socialiste të Çekosllovakisë dhe Hungarisë

³⁸ Hari S.Truman – President i SHBA-së gjatë kohës 12 prill 1945 – 20 janar 1953 dhe

³⁹ Dvajt Ajzenhauer – President i SHBA-ve gjatë kohës: 20 janar 1953 – 20 janar 1961

përkrahje dhe interes gjeopolitik i SHBA-së, meqenëse, kundërshtim jugosllav ndaj BRSS⁴⁰ përçonte mesazh të fuqishëm tek shtetet tjera se mundën të mos i bashkangjiten apo të dalin nga pakti i Varshavës dhe të ekzistojnë e zhvillohen si shtete të pavarura.

Në analizën e CIA-së *“The Trend of Soviet Yugoslav Relations”*, të 18 Nëntorit të vitit 1948, CIA⁴¹ ka vlerësua se veprimi i Titos të kundërshtoj Bashkimin Sovjetik ka paralajmruar plasaritjen e parë serioze të “perandorisë ruse⁴²” ndërsa George Frost Kennan⁴³ të cilit iu besua detyra që të definon politiken amerikane ndaj Jugosllavisë pas konfliktit dhe kercnimeve të Moskës ndaj Jugosllavisë në raportin e tij *“The Attitude of this Government Towards Events in Yugoslavia”*, potencon se rasti i Jugosllavisë determinon faktin se në “levizjen botërore komuniste rasti i jugosllavisë pasqyron një fakt të ri shumë domethënës i cili deshmon se shtetet e ashtuquajtura satelite mund me sukses të kundërvihen Bashkimit Sovjetik.

Fillimi i shpërbërjes së Jugosllavisë

Për shkak të tendences së Serbisë të mbizotroi mbi organet qendrore të Jugosllavisë dhe në armatën jugosllave, filluan levizjet e disa republikave, konkretisht të Sllovenisë e Kroacisë që insistonin në ndryshimin e rregullimit të sistemit shtetror të Jugosllavisë, nga rregullimi i saj federativ në atë konfederativ, gjegjësisht, si bashkësi të shteteve të pavarura.

Shpërbërja e “Jugosllavisë së Titos” formalisht filloj me tentim pengimin e ardhjes së përfaqësuesit të Kroacisë, Stipe Mesiç në krye të Kryesisë së Jugosllavisë nga Serbia dhe republika tjetër, satelite e saj, Mali i Zi në vitin 1990... Një veprim i tillë i Sebisë u shfrytëzua për levizjen para, deri atëherë të heshtur të procesit të pandalshëm të shpërbërjes së RSFJ-së e cila ishte “sekret i njohur publik” që nga dita e vdekjes së Josip Broz Titos⁴⁴.

Kroacia dhe Sllovenia procesin e saj të pavarësisë e filluan me revizionin e

⁴⁰ BRSS- Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike

⁴¹ Agjencia kryesore e Intelejencës të SHBA-së (Central Intelligence Agency)

⁴² From “National Communism” to National Collapse, US Intelligence Community Estimative, Products On Yugoslavia, 1948-1990, *“The Trends of Soviet-Yugoslav Relations, 18 November 1948”*, Washington, 2006,

⁴³ George Frost Kennan ishte diplomat dhe historian amerikan. Ai ishte më së tepërmi i njohur si avokat – predikues i politikave për kontrollin e zgjerimit të Rusisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, ku më vonë u bë edhe vet protagonist...

⁴⁴ Josip Broz Tito - kryetar i RSFJ-së që nga pas Lufta e Dytë Botërore e deri në vdekjen e tij në vitin 1980

Kushtetutave të tyre me të cilat Kroacia bëhet shtet i kroatëve, ndërsa Sllovenia, shtet i sllovenëve dhe kur këto dy republika në verën e vitit 1989 vendosen që të i terheqin forcat e tyre policore nga Kosova ku i dergonin që nga viti 1981, u bë e qartë se këto dy republika e kanë filluar rrugën e tyre “pa kthim” drejt pavarësisë së tyre.

As administrata e kryetarit Bush⁴⁵ e as administrata e presidentit Clinton⁴⁶ nuk e kanë konsideruar dhe trajtuar ngjarjet dhe konfliktet fillimisht politike në jugosllavi si çështje me interes vital për SHBA-të. Shkendijat e para për një intersim më përmbajtësor për ngjarjet në Jugosllavi, filluan tek pas disa viteve të luftimeve të përgjakshme në Bosnjë e Hercegovinë⁴⁷, ndërsa, kthesën në çasjen dhe veprimin aktiv të SHBA-së ndaj konflikteve në Jugosllavi me e bën krimi serb i njohur si Masakra e Srebrenicës⁴⁸.

Prishja e raporteve Jugosllavi (Serbi) me SHBA

Shkendijat e para të keqësimit të raporteve të Serbisë me SHBA-të në aspektin dipolmatik mund të konsiderohet që kanë filluar që në vitin 1989 kur presidenti i Serbisë, Slllobodan Millosheviq⁴⁹, publikisht akuzon ambasadorin e SHBA-së në Beograd Warren Zimmermann⁵⁰ se e ka organizuar korin diplomatik të shteteve të akredituara në Beograd ta bojkotojnë shenimin e 600 vjetorit të “Betejës së

⁴⁵ George Herbert Walker Bush, presidenti i 41 i SHBA-së në vitet 1989 -1993 dhe zëvendës president i SHBA-së në administratën e presidentit Ronald Reagan gjatë viteve 1981-1989

⁴⁶ William Jefferson *Clinton* (Bill Clinton) presidenti i 42 i SHBA-së gjatë viteve 1993 - 2001

⁴⁷ Bosnja e Hercegovina-një nga gjashtë republikat e ish Jugosllavisë

⁴⁸ Masakra e Srebrenicës është krimi luftës me përmasa të gjeocidit që e ka bërë Ushtria e Republikës Serbe nën komanden e Ratko Mlladiqit i cili në vitin 2017 nga Gjykata Ndërkombëtare në Hagë u denua me burgim të përjetshëm për 10 pika të aktakuzës: gjenocid në Srebrenicë, persekutim, shfarosje, krime kundër njerëzimit, vrasje, veprime çnjerëzore e veprime johumane të transferimit të dhunshëm të popullatës civile (kryesisht: gra, fëmijë e pleq), deportim, terrorizim dhe sulme të paligjshme ndaj civilëve, marrja e pengjeve. Në masakren e Srebrenicës janë vrarë mbi 8000 boshnjakëve prej 12 deri në 77 vjeç nga Ushtria e Republikës Serbe, formacionit paraushtarak “Shkorpia” të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe qibdra vullnetarë Rusë dhe Grek...

⁴⁹ Slllobodan Millosheviq ishte kryetar i Serbisë gjatë viteve 1989-1997 dhe kryetar i Jugosllavisë së mbetur RFJ (Republikës Federale të Jugosllavisë të përbër vetëm nga Serbia e Mali I Zi. Slllobodan Millosheviqi u akuzua për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Gjykata Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë në Hagë. Vdiq gjatë gjykimit në Hagë në vitin 2006.

⁵⁰ Warren Zommermann ishte ambasadori i fundit në Jugosllavi (RSFJ-Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë)

Kosovës”⁵¹ në Gazimestan dhe njëkohësisht e akuzonte se ambasadori amerikan po tenton ta kthen opinionin dhe diplomacinë nderkombëtare kundër tij (Millosheviqit). Për çka, Millosheviqi me aparatin e tij propagandistik nisë një kampanjë linçuese ndaj Zimmermanit, gjegjësisht SHBA-së. Në këtë kontekst, meqenëse Millosheviqi në fjalimin e tij në tubimin në Gazimestan me rastin e shenimit të 600 vjetorit të Betejes së Kosovës kercnon publikisht të gjithë se do të shfytëzon edhe forcen e armatosur për mbrojtjen e interesave të Serbisë në kuadër të Jugosllavisë,

Louis Sell,⁵² diplomati amerikan dergon punëdhënësve të tij në Vashington depeshen ku potencon se “në Millosheviqin nuk mund të llogaritet dhe nuk mund asgjë të mirëpret nga Ai”⁵³

Edhe pse nga ambasada amerikane në Beograd, Vashingtonit u dergonin shkresa e informacione për rrjedhat dhe zhvillimet e krizave shqetësuese dhe të rrezikshme në Jugosllavi, kjo situatë për SHBA-të ishte sekundare në raport me ngjarjet dhe interesat e tyre rreth reunifikimit të Gjermanisë, ngjarjeve në Bashkimin Sovjetik, gjegjësisht shpërbërjen e saj dhe situatës në Lindjen e Afërt.. Ambasadori Zimmerman në një takim të ambasadorëve të shteteve evropiane në vitin 1989 në Bruksel, çuditet për një paimnterim total për ngjarjet në Jugosllavi⁵⁴.

Administrata amerikane hezitonte që të mirret seriozisht me krizen jugosllave, por nga ana tjetër Kongresi i SHBA-së, çasjen e problemit të Jugosllavisë, kryesisht e shihte nga prizmi i çështjes së Kosovës, për të cilën shprehnin një intersim dhe shqetësim të jashtëzakonshëm, për çfarë deshmojnë një numër i madh të debateve dhe të rezultave në temën e Kosoves, disa nga të cilat po i pasqyroj në formë të shkurtër edhe në këtë punim: Që nga fillimi i trajtimit të çështjes së Kosovës si vetëm problem i të drejtave të njeriut Kongresi amerikan përmes debateve dhe rezolutave të saja kritikonte administratën shtetërore të SHBA-ve, për pasivitetin, hezitimet dhe çasjen joadekuatë ndaj problemit të Kosovës. Në këtë drejtim më të zëshmit ishin: Xhozef Diogardi, përfaqësues i dhomës së ulët të Kongresit Amerikan dhe njëkohësisht drejtuës i lobit shqiptarë – amerikan, kolegu i tij demokrat Tom

⁵¹ **Beteja e Kosovës** u zhvillua me 28 qershor [1389](#) ndërmjet një koalicioni ballkanik, dhe [Perandorisë Osmane](#).

⁵² Oficer i shërbimit të jashtëm në pension, Louis Sell, oficer i shërbimit të jashtëm amerikan, punoi për gjashtë vite në Ambasadën e SHBA në Moskë dhe tetë vite në vende të ndryshme në Jugosllavi. Nga viti 1995 deri në vitin 1996 ai ishte këshilltar politik për Carl Bildt, Përfaqësuesin e Lartë të Parë për Zbatimin e Paqes në Bosnjë. Në atë kapacitet ai mori pjesë në Konferencën e Paqes të Dejtonit dhe mori pjesë në vitin e parë të zbatimit të marrëveshjeve të Dejtonit. Në vitin 2000 shërbeu si Drejtor i Grupit Ndërkombëtar të Krizave në Kosovë

⁵³ Simic, Predrag, , “Tito I NATO. Uson i pad druge Jugoslavije”, Beograd, Novosti, fq.138

⁵⁴ Zimmermann, Warren. “Burimet e një katastrofe” fq.21, Besa”, Tiranë, 1996,

Lantosh, senatori republikan Bob Dol si dhe senatori Alfonso D'Amato kërkonin dhe insistonin tek administrata e Kryetarit të SHBA-ve, Xhorxh Bush që të ndërhynte tek rezhimi i Beogradit dhe të kërkon të ndërpritet dhuna ndaj demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.⁵⁵

Në raportin e senatorit Bob Dol lidhur me vizitën e delegacionit të Kongresit amerikan Kosovës, në gusht të vitit 1990, potencohet se qeveria e Serbisë e përkrahur edhe nga qeveria qendrore e RSFJ-së, po zbaton shtet policor. Senatori Dol, shprehet se SHBA-të, nuk guxon, nuk mundet që ende të mbesin anash këtij problemi dhe se kanë obligim moral që të vendosen në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, dhe kërkonin ndërhyrjen e vendosur në këtë drejtim nga Vashingtoni⁵⁶.

Shkelja e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë ka qenë shkas që kongresisti amerikan Don Nickles të paraqes para Kongresit draft ligjin për ndërprerjen e ndihmës ekonomike ndaj Jugosllavisë i cili në formë më të zbutur për shkak të ndërhyrjes së kongresistës proserbe Helen Deliq-Bentley, u aprovua në nëntor të vitit 1990 si "Amandmani Nickles&Bentley". Amandmani në fjalë parashihte se SHBA-të do ta ndërpresin ndihmen ekonomike Jugosllavisë po që se nuk zhvillohen zgjedhjet e lira dhe demokratike në të gjitha republikat dhe nëse Serbia nuk e ndërpret shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë. Sekretari i shtetit të SHBA-ve James Beker me këtë rast shfrytëzoi të drejtën e tij të diskrecionit dhe nuk lejoi hyrjen në fuqi të këtij amandmani, meqenëse sipas vlerësimit të administratës amerikane, cak i saj nuk do të jet Millosheviqi por reformat e Kryeministrit jugosllav Ante Markoviq⁵⁷.

Se administrates të SHBA-së nuk i interesonte përmbajtësisht çështja e tërësishme e Jugosllavisë deshmton edhe dokumenti i 18 Nëntorit 1990 i evidentuar si **NIE 1590** e i emertuar "Jugosllavia e transformuar" (Yugoslavia Transformed) i cili dokument ishte një analizë e shumë sherbimeve inteligjente amerikane e cila pasqyronte vlerësime diametralisht të kundërta me qëndrimet e Stejt Departamentit dhe Këshillit për Siguri të SHBA-së⁵⁸. Analiza e sherbimeve inteligjente ka pasur katër perfundime:

Jugosllavia do të pushon së funksionuari si shtet federative në afat prej një viti e në afat prej dy viteve sigurisht jugosllavia do të shpërbëhet. Reformat

⁵⁵ Warren, Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, SHB "Besa", Tiranë, 1996, fq. 28.

⁵⁶ Congressional Record, US Senate, „Yugoslavia“, vol.136, no.85, 28 June 1990, S9165

⁵⁷ Warren, Zimmermann, *Burimet e një katastrofe*, SHB "Besa", Tiranë, 1996, fq. 109.

⁵⁸ National Intelligence Estimate, NIE 15-90: „Yugoslavia Transformed“, Director of Central Intelligence, Langley, VA, 18 October 1990

=====

ekonomike nuk do ta ndalojnë shpërbërjen.

Srbija do të bllokoi tendencat e Sllovenisë dhe Kroacisë për kalimin e Jugosllavisë nga rregullimi federativ në atë të konfederatës jugosllave

Në Kosovë do të vie deri të kryengritja afatgjate e shqiptarëve. Luftë me përmasa të gjëra në mes të republikave nuk parashihet por konfliktet serioze në mes të bashkësive do të vazhdojnë procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë çfarë është aktualisht. Dhuna do të jetë e pazgjidhshme dhe e hidhur.

Ka shumë pak gjëra që aleatët amerikanë dhe evropianë mund të ndërmarrin për të ruajtur unitetin e Jugosllavisë. Jugosllavët do të shohin përpjekje të tilla si tendenca kundërshtuese ndaj demokracisë dhe vetëvendosjes.

Vlerësimi bazik i një analize të tillë të shërbimeve inteligjente amerikane konfirmonte se nuk ekziston vullnet politik më tek asnjë palë konfrontuese për të vazhduar rrugëtimin e përbashkët në Jugosllavi. As Partia Komuniste e Jugosllavisë e as Armata Jugosllave nuk do të jenë në gjendje ta sigurojnë, garantojnë apo imponojnë vazhdimsinë apo riunifikimin e shtetit. Si dhe vlerësimi se sistemi federativ i shtetit brenda një viti do tëpushon së funksionari e brenda dy viteve Jugosllavia si shtet i tillë do të shpërbëhet⁵⁹.

Fillimi i fundit të RSFJ-së - Shkëputja e Sllovenisë dhe Kroacisë

Zgjedhjet e para plurale në Jugosllavi të vitit 1990 deshmuan se “vëllazrim bashkimi i kombëve dhe kombësive ka perënduar dhe po instalohet koha e nacionalizmave lokale. Pos në Serbi dhe Mal të Zi në të gjitha republikat tjera Partia Komuniste i humb zgjedhjet dhe në ato republika vien në pushtet lideret e partitë nacionaliste kombëtare që edhe përmbajtësisht paralajmruan shpërbërjen e Jugosllavisë

Pas zgjedhjeve të vitit 1990, me fillimin e vitit 1991, Sllovenia dhe Kroacia. Ndërprenë zbatimin e ligjeve federative në republikat e tyre. Rrjedha e tillë ngjarjeve imponuan një seri takimesh të kryetarëve të 6 republikave të Jugosllavisë për të ardhmen e federates jugosllave, me çrast në keto bisedime asnjë nga lideret e republikave nuk kerkuan apo insistuan që edhe Kosova të jetë pjesë e këtyre bisedimeve.

Sllovenia dhe Kroacia insistonin në propozimin e tyre për krijimin e një

⁵⁹ US Intelligence Community, *From „National Communism“ to National Collapse, Estimative Products on Yugoslavia, 1948-1990, Yugoslavia Transformed*, National Intelligence Council, Government Printing Office, 2006, 655-674

=====

Konfederate të shteteve të pavarura ndërsa nga ana tjetër Serbia gjegjësisht lideri i saj Slllobodan Millosheviq këmbëngulte në ruajtjen e federates centraliste. Por këto biseda që nga fillimi ishte e qartë se nuk do të hasin në kompromise nga asnjëra palë. Të gjithë në Jugosllavi e dinin dhe nuk ishin të gatshëm të vazhdojnë të jetojnë në një shtet të përbashkët, por për fat të keq bashkësia ndërkombëtare këtë nuk e kuptonte dhe pasi nuk e kuptonte, tentonte dhe insistonte me çdo kusht të ia imponoj të gjithëve vazhdimin e bashkëjetesës në një shtet të përbashkët, qendrim ky që rezultoi me luftrat më të përgjakshme në Evropë që nga pas Luftës së Dytë Botërore.

Luftërat në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë Sllovenia

Për shkak të shpalljes së pavarësisë nga ana e Sllovenisë me 27 qershor 1991, dy ditë më pas Sllovenia u sulmua nga APJ dhe kështu filloj Lufta dhjetëditëshe në Slloveni e cila ishte rrjedhojë e tendencave sllovene për demokraci dhe pavarësi. SHBA, ia bën me dije APJ-së se nuk do të toleron që ushtria të bëhet arbitër në zgjidhjen e krizës jugosllave, dhe se SHBA nuk do të pranoj përdorimin e forcës nga Serbia për ta ruajtur Jugosllavinë.⁶⁰

Më 25 qershor të vitit 1991, Kuvendi slloven miraton Ligjin kushtetues për pavarësi. Me këtë ligj, simbolet dhe flamujt jugosllavë hiqen dhe në anën tjetër vendoset kufiri me Kroacinë. Të njëjtën, ditë në Beograd mbledhet Këshilli Ekzekutiv Federativ, i cili nxjerr urdhër për mbrojtjen e kufijve në Slloveni dhe me këtë armata dhe forcat policore jugosllave marrin dritën jeshile për sulme të armatosura kundër Sllovenisë. Sulmet e APJ-së kundër Sllovenisë filluan më 26 qershor 1991. Armata jugosllave ishte në epërsi të madhe ushtarake, qoftë për nga numri i ushtarëve, qoftë për nga armatimi. Gjatë natës, midis të premtës dhe të shtunës (më 28 dhe 29 qershor 1991), përfaqësuesit sllovenë takohen në Zagreb me tre ministra të Punëve të Jashtme të Komunitetit Evropian dhe me kryetarin e Këshillit Ekzekutiv Federativ. Aty arrihet një marrëveshje për ndërprerje të armiqësive, e cila ishte shumë e paqartë dhe si e tillë edhe kurrë nuk u zbatua⁶¹.

Sllovenia kufijtë e vet i futi nën kontroll më 4 korrik 1991, kurse më 7 korrik 1991, përfaqësuesit e Sllovenisë, përfaqësuesit e RSFJ-së dhe përfaqësuesit e Komunitetit Evropian takohen në ujdhesat Brione. Deklarata e Brioneve krijon moratorium tremujor në pavarësinë sllovene. Megjithatë, forcat e armatosura sllovene mbajtën sovranitetin e plotë ndaj territorit slloven. Si rezultat, Presidenca e RSFJ-së, më 18 korrik 1991, mori vendim për tërheqje të trupave dhe të armëve të

⁶⁰ US Department of State Daily Press Briefing, 110, Tuesday, 9/3/91

⁶¹ <http://www.slovenija2001.gov.si/10years/path/war/> (qasur më 17. 2. 2015).

=====

APJ-së nga Sllovenia brenda tre muajve, ndërmjet 25 dhe 26 tetorit, ushtarët e fundit lëshuan portin e Koprit⁶².

Procesi i shkatërrimit praktik të Jugosllavisë nisi me shpalljen e Pavarësisë së Sllovenisë, në qershor të vitit 1991, i cili veprim u shoqërua me një luftë dhjetëditëshe⁶³ të njësive të Mbrojtjes Territoriale të Sllovenisë kundër Ushtrisë së Jugosllavisë.

Martti Ahtisaari në librin e tij “Detyra në Beograd” potencon rolin dhe ndikimin e liderëve të shteteve të fuqishme në rrjedhat e një çështjeje të përcaktuar, si interes a dëshirë e tyre. Këtë e argumenton me faktin se vetëm në bazë të vullnetit, sidomos të Gjermanisë dhe të ministrit të saj të Punëve të Jashtme, Hans-Dietrich Genscher, vendet e Bashkimit Evropian njohën pavarësinë e Sllovenisë dhe të Kroacisë në vitin 1992.

Kroacia

Lufta në Kroaci shpërtheu nga shkaku se kroatët dëshironin të krijojnë shtetin e pavarur kroat, ndërkohë që serbët kërkonin krijimin e “Serbisë së Madhe”, duke uzurpuar një pjesë të konsiderueshme të territorit kroat, ku banonin serbët vendorë. Fillimisht, APJ dëshironte të mbante nën kontroll gjithë territorin kroat, por kur kjo bëhet e pamundur, atëherë forcat serbe krijuan të vetëshpallurën Republikën Serbe të Krajinës.

Si ia filloi: Në përpjekjet për pavarësi, në njëërën anë, dhe në angazhimet për Serbi të Madhe, në anën tjetër, në Kroaci u mbajtën zgjedhjet e para shumëpartiake, në prill të vitit 1990, të cilat i fitoi partia HDZ (Hrvatska Demokratska Zajednica), të cilës i printe Franjo Tudjman, i cili u zgjodh kryetar i Kryesisë së Kroacisë. Ai publikoi Programin e pavarësisë të Kroacisë dhe të daljes së saj nga Jugosllavia.

Në fund të muajit korrik të vitit 1991, presidenti i Kryesisë së Kroacisë z. Franjo Tugjman e informon ambasadorin amerikan në Jugosllavi Warren Zimmerman mbi planet e Kroacisë për të filluar ofanzivën ushtarake kundër APJ-së dhe “forcave çetnike serbe” në Kroaci dhe shpreson se në këtë drejtim do ta ketë përkrahjen dhe ndihmen e SHBA-së. Ambasadori Zimmerman kërkesat e tilla të Tugjmanit nuk i ka pranuar dhe i ka konsideruar si jo reale dhe njëkohësisht e ka njoftuar që të mos kalkulojë asnjë aksion ushtarak duke shpresuar në ndihmen e SHBA-së⁶⁴.

Përpjekje e plane paqeje do të bëhen në vazhdimësi. Në këtë vazhde

⁶² <http://www.slovenija2001.gov.si/10years/path/war/> (qasur mw 17. 2. 2015).

⁶³ Buja, Ramë, *Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë*

⁶⁴ Zimmerman, Warren, *Burimet e një katastrofe*, botuar Besa, Tiranë, 1996, fq.126

përmendim Planin e Vensit⁶⁵, plan ky që hap rrugën për vendosje të trupave ndërkombëtare të paqes, të njohura si kaskadat blu.

Në bisedimet e përfaqësuesëve të SHBA-së me kreun e APJ-së, amerikanët shprehnin shqetësimin për tendencën e planifikur të serbizimit të ushtisë jugosllave. Në memoaret e tij kryetari i Sllovenisë Janez drvnoshek potencon se presioni amerikan e ka parandaluar njësitet tenkiste të APJ-së të hynë në Slloveni.⁶⁶

Lufta në Kroaci zgjati nga viti 1991 e deri në vitin 1995, në forma dhe intensitete të ndryshme. Në gusht të vitit 1995, forcat kroate, në bashkëpunim me Korpusin V të Armatës së Bosnjë-Hercegovinës, nga zona e Bihaçit, zhvilluan operacionin OLUJA, me çka pjesa perëndimore e RSK-së vihet nën kontrollin kroat, përfshirë edhe qytetin kryesor Knin. Kjo ka shkaktuar një ekzod masiv të serbëve, sikundër edhe numër të madh të krimeve të luftës⁶⁷.

Bosnjë-Hercegovina

Martti Ahtisaari në librin e tij “Detyra në Beograd”⁶⁸, në këtë mënyrë e paraqet fillimin e luftës në Bosnjë-Hercegovinë: “Jo shumë kohë pas fillimit të luftërave në Slloveni dhe në Kroaci, Bosnjë-Hercegovina, me më pak se katër milionë banorë, ndoqi shembullin e Sllovenisë dhe të Kroacisë. Presidenti Izetbegović organizoi referendumin⁶⁹ për pavarësi. Serbët e Bosnjës e bojkotuan votimin, kurse shumica dërrmuese e kroatëve dhe e myslimanëve përkrahën pavarësinë dhe në fillim të marsit të vitit 1992, ajo u shpall.

Aktivitetet e politikës ekspansioniste dhe luftës për territore, gjithnjë me qëllim të krijimit të “Serbisë së Madhe” vazhdojnë edhe në Bosnjë-Hercegovinë. Këtu, fatkeqësisht, lufta filloi të marrë përmasa shumë dramatike, luftë e cila, varësisht nga burimet që kemi, ka marrë qindra e mijëra jetë njerëzish. Thjesht, lufta e Bosnjë-Hercegovinës ka marrë përmasat e genocidit të ushtruar nga një shtet, nga një popull, nga një ushtri kundër një populli tjetër. Pra, Serbia, me gjithë arsenalin e vet, ushtron gjenocid kundër popullatës shumë pak të mbrojtur myslimane të Bosnjë- Hercegovines.

⁶⁵ Shih Planin e Sajrus Vens (Cyrus Vance) dhe lordit Owen për Bosnjen dhe Hercegovinën. Në nëntor të vitit 1991, përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara [Sajrus Vens](#) propozon Planin sipas të cilit Krajina të demilitarizohet (armatimi të mbyllet në depo sipas sistemi të “çelsit të dyfishtë”) dhe të cilat armë do të ruhen nga forcat paqësore të KB (“helmetat blu”) të cilat do të ishin të vendosur në tërë territorin deri sa do të mbaheshin bisedimet politike.

⁶⁶ Zimmerman, Warren, *Burimet e një katastrofe*, botuar Besa, Tiranë, 1996, fq.124

⁶⁷ http://sh.wikipedia.org/wiki/Rat_u_Hrvatskoj (qasur me 12. 2. 2015)

⁶⁸ Ahtisaari, Martti, *Detyra në Beograd*, Shtëpiabotuese Trend, Tiranë, 2012

⁶⁹ Referendumi në BeH u organizua me 29 shkurt dhe 1 mars 1992.

Ndaj kësaj gjendje trishtuese në BeH,KS i OKB aprovon Rezolutën 752 me të cilën vendoset shpërndarja e forcave ndërkombëtare UNPROFOR sa më parë në BeH.

Sarajeva shpejt bëhet e njohur si qytet, ku serbët godasin me snajper qytetarët e pashpresë në rrugë, përfshirë kështu edhe rreth 3500 fëmijë⁷⁰.

Aksionet serbe kundër popullatës myslimane bëhen shumë të njohura, sipas mënyrës së zbatimit ajo konsiderohej si spastrim etnik. Lufta në Bosnjë-Hercegovinë shënon një ndër luftërat më të tmerrshme qysh nga Lufta e Dytë Botërore, ku popullata e pambrojtur myslimane i nënshtrohet sulmeve barbare dhe tmerreve nga vrasjet masive, shfarosje në masë, dhunime, kampe përqendrimi dhe shkatërrimi masiv të territoreve, objekteve fetare dhe kulturore etj.

Tek pas vrasjeve të dhjetëra e mijëra civilëve në këtë luftë, bashkësia ndërkombëtare filloi të eksperimentojë dhe të shqyrtojë plane për ndaljen e luftës në Bosnjë. Në kuadër të saj, “në pranverë të vitit 1993, ish-ministrit të Punëve të Jashtme të Shteteve të Bashkuara, Cyrus Vance, si përfaqësues i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së dhe ish-ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë, lordi Owen, si përfaqësues i BE-së, e kishin prezantuar planin i tyre për ndarjen e Bosnjës në dhjetë kantone, sipas modelit të Zvicrës. Ky i ashtuquajtur plan VOPP nuk u miratua kurrë, po as plani për ndarjen e Bosnjës ndërmjetserbëve të Bosnjës dhe lidhjes së myslimanëve dhe të kroatëve me proporcion 49-51 për qind”⁷¹.

Kërkesen e komandantit të UNPROFOR-it, gjeneralit Rupert Smit që të vazhdohet me bombardimet e NATO-s, për çudi refuzohet nga udhëheqja më e lartë ushtarake e civile e KB në BeH nga frika për sigurinë e pengjeve dhe stafit të KB. Në mbledhjen urgjente të KS të OKB-së për gjendjen e tillë në BeH, asnjë nga anëtarët nuk ka insistuar në sulmet e NATO-s⁷².

Një sjellje të tillë hezitues dhe të të friges, misioni i KB në Beh e ka treguar edhe me rastin e Masakrës së Srebrenicës kur kanë refuzuar t’i mbrojnë civilët boshnjak nga masakra serbe! Paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara krijuan zona të mbrojtura dhe pikërisht është një zonë e ashtuquajtur e mbrojtur, që do të shënojë kasaphanën më të madhe të ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore.

⁷⁰ <http://www.historyplace.com/worldhistory/genocide/bosnia.htm> (qasur mw 21. 2. 2015).

⁷¹ Ahtisaari, Martti. *Detyra në Beograd*.Trend, Prishtinë, 2008. Fq. 20

⁷² S. Engelberg and E. Schmitt: “NATO Bombing and Serb Hostage-Taking Now Mark Turning Point in War

“New York Times, July 16, 1995;

R. Cohen, “NATO May Be Called on to Silence Guns in Sarajevo”, New York Times, May 25, 1995.

Forcat serbe, nën komandën e komandantit famëkeq serb Ratko Mladiq, në zonën e Srebernicës. bënë kasaphanën e njohur të Srebernicës, ku masakrohen 8000 meshkuj të moshave prej 12 deri në 60, për të vazhduar me dhunime masive të femrave boshnjake.

Prapë, për shkak të autoritetit dhe ekspertizës që e gëzon në arenën diplomatike ndërkombëtare, po e pasqyroj një përcaktim dhe vlerësim të Martti Ahtisaarit, të publikuar në librin e tij “Detyra në Beograd”, përkitazi me raportin e OKB-së dhe të bashkësisë ndërkombëtare ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Bosnjë. Ai thotë: “Fillimisht, ndaj gjithë kësaj lufte barbare nga ana e Serbisë dhe serbëve të Bosnjës, OKB-ja përpqej të ushtronte ndikim në këtë situatë me anë të Rezolutës, sipas së cilës u vendosën sanksionet ekonomike ndaj Serbisë dhe u dërguan trupat e UNPROFOR-it, fillimisht në Kroaci për të mbrojtur aktivitetet humanitare në rajon.

Një sjellje e tillë e bashkësisë ndërkombëtare, jo vetëm që nuk ofronte zgjidhje për përfundim të luftës, përkundrazi përçonte mesazh se nuk është edhe aq e interesuar të kyçet në zgjidhjen e kësaj vatre të krize humanitare. Për këtë arsye, lufta vazhdoi deri në vitin 1995. Vetëm Masakra e Srebernicës, ku në mënyrë më brutale u vranë 8000 civilë myslimanë, e detyroi më fund bashkësinë ndërkombëtare që të mos heshtë, por të veprojë, në emër të humanizmit, civilizimit dhe të qytetërimit botëror. Deri atëherë, në Bosnjë kishin vdekur rreth 300.000 njerëz dhe 2.7 milionë të tjerë ishin bërë refugjatë”⁷³

Hezitimi, pengimi, vonesa e ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar në BeH, sikurse më vonë në Kosovë etj. vjen si shkas i mospërputhjeve në mes të faktorit politik dhe atij ushtarak të Fuqive të Mëdha, në rradhë të parë të SHBA. Konkretisht, me këtë rast për përdorimin e forcave amerikane në ndërprerjen e tragjedisë humanitare në BeH ishin Kolin Pael, kryeshefi i gjeneralishtabit të ushtrisë amerikane dhe Dik Çejni – sekretari i mbrojtjes, të cilët ishin kategorik në kundërshtimin e angazhimit të akcioneve ushtarake në BeH pa e pasur të definuar një plan të caceve të qarta politike dhe një strategji dalëse.

Më 30 gusht 1995, më në fund fillon sulmi masiv i NATO-s, i prirë nga SHBA, si kundërpërgjigje për vrasjet masive në Srebernicë, duke vënë në shënjestër pozitat e artilerisë serbe gjithandej Bosnjës. Bombardimet vazhduan edhe në tetor. Bombardimet u bënë nga 60 aeroplanë, nga bazat në Itali dhe nga aeroplanbartësja USS ‘Theodore Roosevelt’ në Adriatik⁷⁴. Forcat serbe humbin sipërfaqe në favor të boshnjakëve, të cilët në një mënyrë armatoseshin nga bota islame. Si rezultat.

⁷³ Ahtisaari, Martti. *Detyra në Beograd*. Trend, Prishtinë, 2008. Fq. 20

⁷⁴ Albright, Madeleine, *Zonja Sekretare (autobiografi)*, SHB “Dudaj”, Tiranë, 2004, fq. 229.

gjysma e Bosnjës merret nga trupat myslimano-kroate⁷⁵.

Konferenca e Dayton-it

I ballafaquar me sulmet e forcave të NATO-s. Milosheviqi detyrohet të futet në bisedime paqësore, të cilat organizohen në Dayton (OHIO) të SHBA, të cilat fillojnë më 1 nëntor të vitit 1995, të njohura me emrin bisedimet e Konferencës së Daytonit. Tri javë bisedime në Dayton, të cilat, pos tjerash, sjellin ndarjen e Bosnjës në dy entitete: pjesa serbe e Bosnjës dhe pjesa e federatës boshnjako-kroate e Bosnjës.

Lufta e Bosnjës, sipas Richard Hoolbroke, konsiderohet dështimi më i madh i Perëndimit që nga viti 1940⁷⁶. Ndërsa sipas këshilltarit të presidentit Bill Clinton për siguri nacionale Toni Lejk "Bosna është bërë simbol dhe definicion i gjithë plotikës së jashtme amerikane dhe mund ta zbeh e gjith atë çfarë është bërë deri më tani"⁷⁷

I dërguari i Komisionit për Hetimin e Shkeljeve të Ligjit për të Drejtat Humanitare të OKB-së, Sherif Bassiouni, në dëshminë e tij para Kongresit të SHBA-ve, më 4 prill 1995, kishte vërtetuar strategjinë e pastrimit etnik dhe taktikën e vrasjeve, gjymtimeve, dhunimeve të civilëve e forcave serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë⁷⁸.

